

Klimë, studim për shpëtimin e koraleve mesdhetare

E MARTE, 18 MAJ 2010 00:49 BOTA



Itali, 18 Maj NOA - Do të jetë një bashkëpunim midis Italisë dhe Izraelit i cili do të merret me studimin e koraleve mesdhetare për të kuptuar mundësinë e tyre për të mbijetuar. Ky studim do të quhet "CoralWarm" dhe do të nisë në muajin qershor në Tel Aviv.

Kohëzgjatja e tij do të jetë për 5 vite ndërsa për sa i përket investimit që është bërë në këtë kërkim flitet se është hedhur një shumë prej 3.3 milionë eurosh.

Në këtë studim do të shihet mbijetesa e koraleve mesdhetare në lidhje me ndryshimet klimaterike dhe pothohet se do të janë pjesëmarrës universitetet e

Bolonjës, Bar-Ilan dhe laboratorët e palestinezëve të Al Quds University të Jerusalemit.

r.b/NOA

[Shfo komentin tund](#)



Powered by [JoomlaComment 4.0alpha](#)